



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIATE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“RAHOVEC CHANNEL” SH.P.K.


Numri unik identifikues - 811387621

Pronarët: Taulant PALLQA & Arnolld KORENICA

OSHMA ”RAHOVEC CHANNEL”

Rr/Xhelal Hajda, pn

Rahovec



VENDIM

për licencimin e Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audiovizuale ”Rahovec Channel”, për transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes – me seli në Rahovec

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02, ka hyrë në fuqi më 25 janar 2017, ndërsa, me Kreun III të kësaj rregulloreje, KPM ka krijuar bazën ligjore për licencimin e Ofruesve të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale të cilët transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes, e që do të kenë mundësi të prodhojnë programe përmbajtësore dhe t'i transmetojnë ato përmes cilit do operator të shpërndarjes.
3. Më datën 26 shkurt 2020, kandidati ”Rahovec Channel”, ka parashtruar aplikacionin për licencë të KPM-së për të vepruar si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA) për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes.


Arsyetim

4. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së OSHMA ”Rahovec Channel”, në aplikacionin e tij ka paraqitur të dhënat e nevojshme për Licencë të KPM-së dhe në pajtueshmëri me Kreun III të Rregullores KPM-2017/02.

5. Komisioni vlerëson se, kandidati për licencë të KPM-së "Rahovec Channel", ka ofruar të dhënat e mjaftueshme për vlerësim të aplikacionit. Materialet e ofruara si pjesë e aplikacionit konsiderohen të qëndrueshme sa i përket skemës programore në përgjithësi; të dhënat rreth aftësive profesionale dhe menaxheriale për të udhëhequr me ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë edhe të dhënat rreth qëndrueshmërisë financiare.
6. Sipas Nenit 21, paragrafit 5 të Rregullores KPM-2017/02, kandidati për licencë të KPM-së "Rahovec Channel", duhet të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha rregullat dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM, në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, si dhe me ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës.
7. Komisioni konstaton se kandidati "Rahovec Channel", ka parashtrua aplikacionin e tij në pajtim me Ligjin për KPM-në, Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM – 2017/02) Rregulloren për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM - 017/06) dhe në pajtim me Formën e Aplikimit.
8. Komisioni vlerëson se, kandidati "Rahovec Channel", ka përmbushur kriteret kualifikuese për t'u pajisur me licencë të KPM-së për ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale, me përmbajtje tematike, në pajtim të plotë me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/02.

Vendim

9. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 30 tetor 2020, merr vendim që, kandidatit "Rahovec Channel", me seli në Rahovec, t'i lëshoj licencën për të vepruar si Ofrues i Shërbimeve Mediale Audiovizuale me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, në Republikën e Kosovës.
10. Kandidati "Rahovec Channel", mund të fillojë veprimtarin si ofrues të shërbimeve mediale audiovizuale (OSHMA), për transmetim përmes operatorit të shpërndarjes vetëm pas nënshkrimit të Pakos së Licencës të KPM-së.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Xhevat LATIFI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



03.11.2020
datë